



komunistë. Kështu, në prag të okupimit ekzistonte edhe Komiteti Krahinor i BRKJ-së. Për shkak të aktivitetit dhe punës së rinisë qysh në fillim të vitit 1940 në Kosovë ishte një numër i konsideruar njerëzish kundër fashizmit dhe nacizmit. Të rinjtë revolucionarë dhe grupet udhëheqëse të të rinjve në Prishtinë pothuaj në çdo vend demaskuan nazizmin gjerman e fashizmin italian duke shfrytëzuar shfaqjet e shëtijet e ndryshme.¹

Rinia revolucionare e Kosovës, e udhëhequr nga PKJ, gadi në të gjitha qendrat organizon demonstratat më 27. III. 1941.² E udhëhequr dhe e edukuar nga PKJ, BRKJ dhe të rinjtë revolucionarë edhe në fillim të vitit 1941 vijuan të demaskojnë nazizmin e fashizmin, tregon rrezikun e drejtpërdrejtë që i kërcënohet njerëzimit. Në këtë drejtim, sikurse edhe PKJ, edhe BRKJ intensivisht dhe në mënyrë të organizuar përgatitet. Në sajë të këtyre përgatitjeve krahas me komunistët, të rinjtë e Kosovës të të gjitha kombeve e të konfensionëve, në forma të ndryshme i kundërvihen okupimit të vendit. Kishte edhe të tillë që për shkak të ndjenjave patriotike, por të paorganizuar, flijuan jetën për mbrojtjen e vendit.³ Mirëpo, një numër i madh komandash të vendit të Ushtrisë së Jugosllavisë së vjetër kërkesën e tyre që të 'i rrokin armët iu përgjegjën »se ka kush ta mbrojë vendin«. ⁴ Edhe në këto momente të vështira rinia revolucionare nuk u gjuhëzua. Nuk u pajtuan me fatin. Në këto ditë vendimtare anëtarët e PKJ-së dhe të BRKJ-së grumbullojnë e mëshihin armë, municion e material tjetër luftarak. Në anën tjetër, me ndihmën e komunistëve, të rinjtë komunistë shpërndajnë shkaqet e rënies së shpejtë të Jugosllavisë borgjeze.⁵ Kështu, anëtarët e PKJ-së dhe të BRKJ-së përgatiten qysh në ditët e Luftës së Prillit për luftën vendimtare të LNÇ-së dhe të Revolucionit.

2. BRKJ dhe lëvizja e rinisë në Kosovë në vitin e parë të Luftës

Në Kosovë, sikurse edhe në pjesët e tjera të Jugosllavisë, nga organizatat e mëparshme të rinisë në kohën e okupacionit, e vetmja organizatë që mbeti kompakte dhe që mundahej të lidhej me të rinjtë e Kosovës ishte BRKJ. Që të arrijnë këtë BRKJ në Kosovë hasi në të gjitha vështirësitë në të cilat hasi edhe PKJ. Pas okupimit të vendit një numër i konsideruar i anëtarëve të BRKJ-së ishte shkapërderdhur, ndërsa shumë aktive u shuan së ekzistuari sepse

¹ Arkivi i Institutit të Historisë së Kosovës (më tej AIHK) K-18/2 nr. 227/1.

² Po aty.

³ Miodrag Nikolić, *Prizren u NOR-u i revoluciji*, (dorëshkrim), faq. 11. Me rastin e hyrjes së gjermanëve në Prizren në ta shtiu i riu Mile Nojiq. Pokështu një grup i anëtarëve të BRKJ-së dhe i patriotëve nga Rahoveci u përgatitën për mbrojtje dhe u drejtuan në Grykën e Bullgarëve (Po aty).

⁴ Arhiv Vojno-istorijskog instituta u Beogradu, p-17, K-10, F-4. nr. R. 13; Si shën. 1.

⁵ Grup autorësh, *Mitrovica dhe rrethina*, Mitrovicë, 1979, faq. 25.

anëtarët e tyre u shpërngulën në Sërbi e në Mal të Zi. Kur Komiteti Krahinor i PKJ-së shkoi në Mal të Zi, me të shkuan edhe anëtarët e Komitetit Krahinor të BRKJ-së. Brenda kësaj kohe veprome Udhëheqja e Përkohshme e BRKJ-së në përbërje: Branko Shkembaroviqi (sekretar), Ukë Gashi, Musa Muhaxheri, Rexhep Gashi, Kërsta Aleksiqi dhe Mehmet Shoshi.⁶

Në Këshillimin Partiak të Majit (4. V. 1941. në Zagreb) u vendos që anëtarët e PKJ-së dhe BRKJ-së t'i përshtaten kushteve për luftë kundër okupatorit. Kjo vlente edhe për Kosovën, prandaj shumica e anëtarëve të KK të BRKJ-së, në qershor të vitit 1941, u kthyen në Kosovë.⁷ Vërtet, puna në tubimin e rinisë nuk u ndërpre as para kësaj kohe. Në gjysmën e dytë të marsit të vitit 1941 u bë një kthesë në tubimin masiv të rinisë së Pejës. Në këtë kohë në këtë qytet në aktivet e BRKJ-së ishin organizuar një numër i konsideruar të rinjsh.⁸ Po kështu, në maj të vitit 1941 në Gjakovë u vendos që të fillojë puna në organizimin e rezistencës kundër fashizmit, duke përfshirë në radhë të parë rininë antifashiste.⁹ Aktivitetet i tillë zhvillohet edhe në vendet e tjera të Kosovës.

Pas kthimit të KK të BRKJ-së detyrë e parë e tij ishte lidhja e organizatave të BRKJ-së që ishin mbetur edhe pas okupacionit. Përtëritja e organizatës së BRKJ-së në Pejë u bë në fund të tetorit të vitit 1941. U formuan aktivet nëpër rrugë dhe u caktuan udhëheqjet rajonale. Lidhjet me organizatat e tjera deri në muajin tetor nuk u vunë. Ndihej vetëm se në disa qendra punojnë disa aktive të BRKJ-së. Edhe KK i BRKJ-së ekzistonte vetëm formalisht, prandaj në mbledhjen e KK të PKJ-së u vendos që ky të formohet sërish.

Në dhjetor të vitit 1941 u formua Komiteti i Vendit i BRKJ-së në Prizren. Sekretar u zgjodh Kolë Shiroka, ndërsa në këtë kohë, në këtë qytet kishte 12 aktive të BRKJ-së (prej tyre tri aktive në fshatra) me afër 80 komunistë të rinj, prej të cilëve vetëm 10 ishin të kombësisë shqiptare.¹⁰

Fillet e organizimit të rinisë në Gjakovë datojnë që nga maji i vitit 1941, kurse në fund të këtij viti organizata e BRKJ-së në këtë qytet kishte 65 komunistë të rinj të organizuar në 7 aktive. Me organizatën e BRKJ-së në emër të PKJ-së punonte Qamil Brovina.¹¹

Komiteti i Vendit në Prishtinë është formuar në gjysmën e dhjetorit (19. XII. 1941). Sekretar u zgjodh Qedo Bojkoviqi. Në këtë kohë, vetëm në qytet kishte më se 20 aktive me 120 anëtarë të

⁶ Dr Ali Hadri, *Narodnooslobodilački pokret na Kosovu 1941—1945*, Beograd, 1973, 192.

⁷ Millutin Foliqi, *LRKJ dhe lëvizja e rinisë në Kosovë e Metohi 1941—1944*, Zëri i Rinisë, nr. 8, 1969.

⁸ Si shën. 3, 53.

⁹ Dr Ali Hadri, *Đakovnca u NOP*, Priština, 1976, 72.

¹⁰ Si shënimi 3. fq. 33 dhe 53.

¹¹ Si shënimi 9. fq. 95—99.

BRKJ-së dhe disa bërthama. Sukses i dukshëm u arrit edhe në 10 fshatrat e rrethinës. Përveç këtyre aktiveve kishte edhe grupe që nuk ishin në BRKJ, por që punonin si të organizuar.¹²

Puna e rinisë revolucionare në Gjilan dhe në Ferizaj u kushtëzua me organizimin e PKJ-së. Mirëpo, rinia revolucionare e këtyre vendeve, si edhe e qyteteve të tjera të Kosovës, edhe pse jo e organizuar pa u lodhur punonte në propagandimin dhe në organizimin e aksioneve konkrete kundër okupatorit dhe bashkëpunëtorëve të tyre.¹³

Në vitin 1941 komunistët e rinj, së bashku me të rinjtë e tjerë revolucionarë, iu bashkuan çetave dhe batalioneve të prapavijës, përcillnin kurset për përdorimin e armëve, kurset për kryerjen e diverzioneve, kurset për shërbimin sanitar, tubonin pionierët, ilegalisht bartnin lajmet e botuara mbi gjendjen në fronte, sabotonin, merrnin pjesë dhe ndihmonin në ikjen e të burgosurve etj.¹⁴

Nga aksionet, veçanërisht të të rinjve shqiptarë, që duhet përmendur janë pengimi i manifestimeve fashiste dhe kthimi i tyre në demonstrata antifashiste.¹⁵

E meta kryesore në punën e BRKJ-së gjatë vitit 1941 ishte lënja pasdore e punës me rininë tjetër, kurse komunistët e rinj ishin kryesisht nga radhët e kombësisë serbe e malazeze.¹⁶ Në këtë vit u vendos që në vitin 1942 të tejkalohen këto lëshime.

3. Konsolidimi dhe zgjerimi i lëvizjes antifashiste të rinisë së Kosovës dhe aktiviteti i saj nga fillimi i vitit 1942 e deri në Këshillimin e Suhodollit

Qysh në dhjetor të vitit 1941 KK i PKJ-së vendosi që të ndihmohet BRKJ dhe të eliminohet qëndrimi sektar ndaj rinisë.¹⁷ Padyshim kjo ndikoi edhe në formimin e Komitetit të Vendit në Ferizaj. Komiteti i Vendit në Ferizaj formohet menjëherë pas formimit (24 janar 1942) të Komitetit të Vendit të PKJ-së. Sekretar i Komitetit të Vendit u zgjodh Rada Klajiqi. Në këtë qytet në këtë kohë u formuan 10 aktive të BRKJ-së, në të cilët u përfshinë afër 150 të rinj. Po kështu qindra të rinj u tubuan në grupet edukuese të të rinjve midis të cilëve kishte edhe shqiptarë, veçanërisht në fshatrat Sojevë dhe Sazli. Në BRKJ të rinjtë e fshatrave të tjerë pranoheshin individualisht.¹⁸ Në këtë drejtim edhe në Prizren në ja-

¹² Si shënimi 1. Qysh në shtator të vitit 1941 në Prishtinë me vetëiniciativë u formuan aktive të BRKJ-së. Rinia në këtë kohë ishte e ndarë në rininë puëtoare, intelektuale, shqiptare dhe në rininë e gjimnazit. Kjo punë nuk u miratua, sepse nuk ishte e organizuar drejt. (Po aty).

¹³ Si shënimi 6, 192.

¹⁴ Po aty; Si shënimi 5, 250.

¹⁵ Si shënimi 9, 120; Si shënimi 5, 347.

¹⁶ Si shënimi 6.

¹⁷ Akademik Ali Hadri, *Gjendja organizative dhe vija e PKJ-së në Kosovë gjatë Lëvizjes Nacionalçlirimtare (1941—1945)*, Përparimi nr. 2, 1979. 160.

¹⁸ Nikola P. Vidačić, *Na obalama Nerodimke*, Novi Sad, 1967, 196.

nar të vitit 1942, u themelua Organizata e Pionerëve. Shoqëri dhe grupe më aktive të pionierëve të këtij qyteti ishin në Potkala dhe Kurile.¹⁹

Qëndrimi i Këshillimit të KK të PKJ-së u theksua edhe më shumë në Këshillimin e Shkurtit të KK të PKJ-së. Në këtë Këshillim iu dha rëndësi punës me rini dhe rolit të saj në LNÇ dhe në luftën e armatosur kundër okupatorit. Ky qëndrim ndaj BRKJ-së dhe ndaj rinisë revolucionare ndikoi pozitivisht në aktivitetin e organizatave partiake në linjën rreth punës me rini. Po ashtu në këtë kthim të rëndësishëm ndikoi edhe tubimi dhe masivizimi i rinisë rreth BRKJ-së kur u konsiloduan organizatat e PKJ-së.²⁰

Këshillimi i Shkurtit të KK të PKJ-së dha menjëherë rezultate. Në rrethin e Ferizajit si edhe në rrethet e tjera të Kosovës masivizohet lëvizja antifashiste e rinisë.²¹ Qysh në fund të vitit 1942 në Kosovë kishte 1278 anëtarë të BRKJ-së: në Pejë kishte 590 të rinj, në Gjakovë 35, në Prizren 200, në Ferizaj 95, në Prishtinë 250 dhe në Mitrovicë 108 komunistë të rinj.²²

Në muajin mars të vitit 1942 lëvizja e rinisë nuk shquhet vetëm për nga numri dhe për nga masivizimi, por edhe me aktivitete të ndryshme. Duke parë gabimet e veta me lidhjen, me punën dhe anëtarësimin e të rinjve shqiptarë, organizatat e BRKJ-së mundohen që kishte lëshime t'i zbusin disa, por pa suksese të dukshme. Në këtë muaj në Prizren masivizimi i lëvizjes së rinisë antifashiste të të rinjve serbë e malazezë kënaqte, ndërsa mezi mund të thuhet se puna me rininë shqiptare kënaq.²³ Po në të njëjtin muaj në rrethin e Prishtinës (Graçanicës) organizatat e BRKJ-së u zgjeruan, veçanërisht në Suhodoll dhe në Obiliq. Në Lipjan formohen dy grupe pionierësh që i udhëheqnin dy anëtarë të BRKJ-së. Në fshatin Ruvç i Ri formohet një aktiv dhe një bërthamë e BRKJ-së.²⁴

Për shkak të represaljeve të okupatorit kundër pjesëtarëve të LNÇ-së, organizata e BRKJ-së në Pejë për një kohë të shkurtë u përgjysmua. Atëherë KK i PKJ-së u detyrua të kalojë në Gjakovë, ku mbajti disa mbledhje në të cilat u shqyrtuan puna e BRKJ-së dhe puna e rinisë antifashiste si edhe u morën qëndrime për përforcimin e punës së Partisë dhe punës së BRKJ-së.²⁵ KK i PKJ-së vendosi që t'u dërgojë të gjithë komunistëve të rinj letër në të cilën do të përcaktohen detyrat dhe rëndësia e punës me gjithë rininë. Duhej që letrën (e shkruar në gjuhën serbokroate e në gjuhën shqipe ta) nënshkruajë Komiteti Krahinor i BRKJ-së edhe pse nuk ekzistonte. Ky ishte udhëzimi i parë me shkrim i KK të PKJ-së drejtuar komunistëve të rinj.²⁶

¹⁹ Si shënimi 3, 59.

²⁰ Si shën. 6, 193.

²¹ Si shën. 17, 146.

²² Si shën. 19.

²³ AIHK, K-6 dok. nr. 14.

²⁴ Si shën. 1.

²⁵ Si shën. 19.

²⁶ Si shën. 6, 193—195.

Letra direktive e »KK të BRKJ-së« dërguar të gjitha komiteteve të vendeve të BRKJ-së kishte rëndësi të madhe për punën e mëtejshme të BRKJ-së dhe rinisë përparimtare. Në fund të muajit prill të vitit 1942 BRKJ në Kosovë u forcua mjaft. Ekzistonin 5 komitete të vendit e kishte afër 1400 komunistë të rinj (prej tyre në internim ishin afër 150 vetë). Në organizatat e BRKJ-së në Kosovë 85% të anëtarëve ishin serbë e malazezë, ndërsa vetëm 15% shqiptarë. Prej këtyre të rinjve komunistë 35% ishin femra. Në rrethin e Pejës kishte më së shumti anëtarë të BRKJ-së.²⁷ Në Prizren në këtë kohë kishte afër 100 anëtarë të BRKJ-së e në qytet u mbajt Plenumi i Komitetit të Vendit të BRKJ-së. Në këtë plenum u zgjodh sekretarja e Komitetit të Vendit: Jovanka Radivojeviqi.²⁸

Organizatave të BRKJ-së Letra Direktive e »KK të BRKJ-së« u shtronte për detyrë edhe formimin e Lidhjes së Rinisë Nacionalçlirimtare së Kosovës. Në zbatimin e kësaj detyre të rinjtë komunistë punuan deri në fund të vitit 1942.²⁹

Në muajin maj, qershor, korrik e gusht të vitit 1942 në Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe disa vende të tjera u bënë përgatitjet për formimin e Lidhjes së Rinisë Nacionalçlirimtare. Në maj të vitit 1942 në Prishtinë u formuan këshillat e Lidhjes së Rinisë Nacionalçlirimtare thuajse në secilin rajon, në të cilët u përfshinë të rinjtë prej moshës 15—18-vjeçare. Gjithsej u tubuan afër 100 të rinj. Këshilla të tillë u formuan edhe në Lipjan, në Suhodoll e në Vrellë.³⁰

Në gjysmën e dytë të muajit maj të vitit 1942 në Prizren filloi formimi i këshillave të Lidhjes së Rinisë Nacionalçlirimtare. Deri në gjysmën e gushtit të këtij viti kjo formë pune dha rezultate të dukshme. Në këtë kohë, këshilla të këtilla u formuan edhe në Sreçkë. Ky aktivitet mundësoi që në qershor të vitit 1942, mbi Marash të Prizrenit, të mbahet Konferenca e qytetit e Lidhjes së Rinisë Nacionalçlirimtare, në të cilën morën pjesë afër 30 të rinj serbë e shqiptarë. Mirëpo, në të njëjtin muaj në radhët e rinisë serbe fillon përhapja e Lëvizjes Çetnike. Lidhja e Rinisë Nacionalçlirimtare punoi që ky ndikim sa më pak të depërtojë në radhët e kësaj rinie. Për këtë u mbajt një mbledhje e zgjeruar e rinisë serbe e malazeze, në të cilën u fol mbi qëllimet e LNÇ-së, ndërsa për këtë u lexua edhe një referat. Nëpërmes të kësaj pune u arrit deri diku qëllimi, mirëpo një grup i vogël përkrahësish të ideve çetnike edhe më tej i kundërshtonte politikës së BRKJ-së.³¹

Që të pengojë formimin dhe zgjerimin e Lidhjes së Rinisë Nacionalçlirimtare Shqiptare pushteti okupues dhe kuisling në Kosovë ndërmoi masa të shumta që të organizojë rininë nëpër organizata fashiste dhe profashiste. Pushteti okupues dhe kuisling mendohej që të regjistrojë sa më shumë fëmijë në të ashtuquajturat balile, ndërsa rininë prej moshës 14—17-vjeçare në avangardistë. Përgjegje

²⁷ Si shën. 6, 196;

²⁸ Si shën. 3, 55.

²⁹ Si shën. 26.

³⁰ Dr Milan Borković, *SKOJ i omladinski pokret na Kosovu u ratu i u revoluciji (1941—1945)*, Obeležje, 3/1975, 86.

³¹ Si shën. 27, 57.

masive nuk pati me përjashtim të disa familjeve të pasura tregtare dhe atyre bajraktare.³² Midis grupeve profashiste dhe grupeve të rinisë antifashiste shpeshherë pati mosmarrëveshje.³³

Në muajin maj të vitit 1942 në Gjilan u krijuan kushtet për konsolidimin dhe zgjerimin më të mirë të rinisë përparimtare. Komiteti i Vendit i BRKJ-së u formua më 8 maj të vitit 1942,³⁴ ndërsa sekretar i Komitetit të Vendit u zgjodh Darinka Trajqi.³⁵ Pas formimit të Komitetit të Vendit filloi edhe formimi i aktiveve të BRKJ-së. Në qytet u formuan 23 aktive të BRKJ-së me 60 anëtarë. Prej tyre 3 aktive ishin me anëtarë të rinj shqiptarë. Në këtë kohë aktive të BRKJ-së u formuan edhe në fshatrat: Pozhoran, Novo Sellë (Tërpezë e Madhe dhe e Vogël) Llasticë, Ribnik, Binçë e Vitinjë. Të gjithë këta fshatra kishin afër 40 anëtarë të BRKJ-së.³⁶

Në fillim të qershorit të vitit 1942 pas plenumit të Komitetit të Vendit të PKJ-së, në Ferizaj u mbajt mbledhja e komunistëve të rinj, në të cilin u zgjodh Komiteti i Ri i Vendit i BRKJ-së dhe sekretari i tij Rada Klajiqi. Menjëherë pas kësaj në Gërbole u mbajt Këshillimi i komunistëve të rinj nga Ferizaji e rrethina.³⁷

Në Këshillimin e Korrikut u vendos që sa më shpejt të mbahet këshillimi Krahinor i BRKJ-së. Kjo ishte e nevojshme aq më tepër nga se këshillimi i fundit ku u fol mbi rininë u mbajt në Vitomiricë qysh në janar të vitit 1941. Në kohën e okupacionit e deri në gusht të vitit 1942 me organizatat e BRKJ-së udhëhoqnin anëtarë e KK të PKJ-së, sepse një numër i anëtarëve të BRKJ-së u inkuadruan në punët e Partisë apo nuk ishte më në Kosovë. Mosveprimi i KK të BRKJ-së ndikoi mjaft në punën e organizatave të BRKJ-së. Mabajtja e Këshillimit Krahinor të BRKJ-së u bë edhe për shkak të nevojës së trajtimit të problemeve dhe të caktimit të detyrave të drejt-përdrejta të komunistëve të rinj dhe të rinisë tjetër përparimtare.³⁸

Në Këshillimin e BRKJ-së në Suhodoll, afër Prishtinës, u formua KK i BRKJ-së në përbërje: Mita Milkoviqi (sekretar), Rada Klajiqi, Jovanka Radivojeviqi, Qamil Brovina dhe Branko Gërko-viqi. U analizua puna e BRKJ-së dhe u dhanë orientime për punën e mëtejshme të lëvizjes përparimtare.

Nga fillimi i vitit 1942 e deri në Këshillimin e Suhodollit u punua mjaft për inkuadrimin e rinisë në LNÇ dhe në krijimin e bashkimit të rinisë punëtore, fshatare dhe të rinisë intelektuale në luftë kundër fashizmit. Pas kësaj numri i anëtarëve të BRKJ-së dhe i të rinjve antifashistë u shtua. Në anën tjetër u forcua mjaft disiplina, përgjegjësia dhe serioziteti i punës së rinisë. U arritën edhe rezultatet të dukshme në punën me pionierët.³⁹ Mirëpo, ende ishte i pranishëm qëndrimi sektar dhe mosbesimi ndaj rinisë shqiptare,

³² Si shën. 1.

³³ Si shën. 30.

³⁴ »Zëri i Rinisë« nr. 9. 20 maj 1959; Si shën. 17, 152.

³⁵ Bogomir B. Stanković, *Kosovsko Pomoravlje u Revoluciji (1941—1945)*, Nish, 1975, 127.

³⁶ *Po aty*, 130.

³⁷ Si shën. 18, 150.

³⁸ Si shën. 6. 197—198.

³⁹ Si shën. 6. 199—201.

edhe pse tani më ajo »kishte filluar të shohë se nuk ishte e çliruar« dhe se përbën shumicën e rinisë kosovare.⁴⁰ Qëndrim sektar pat edhe ndaj rinisë punëtore. Në Mitrovicë në këtë kohë ishte një numër i madh punëtorësh, të rinj por me ta u punua fare pak.

Përveç këtyre të metave, në këtë kohë organizatat e BRKJ vuanin edhe nga lëshime të tjera. KK i BRKJ-së nuk ishte në një vend dhe nuk u ndihmonte sa duhej komiteteve të vendeve, kurse lidhjet ndërmjet tyre nuk ishin të rregullta. Po kështu, udhëheqjet nuk mbanin kontakte të rregullta me aktivet, ndërsa aktivet nuk u angazhuan mjaft në zgjerimin e punës me pjesën tjetër të rinisë. Aktivitetit të Lidhjes së Rinisë Antifashiste i pengonte shumë edhe mungesa e teknikës.⁴¹

Në gjysmën e parë të vitit 1942 përveç aksioneve të rëndomta të vitit 1941 u bënë edhe aksione të tjera. Komitetet e rretheve dhe të vendeve praktikonin në këtë kohë atentatet e sabotimet si formë të rezistencës kundër okupatorit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Kështu, numri i sabotimeve në fillim të vitit 1941 u rrit mjaft. Shumë sabotime u kryen veçanërisht në stacionet hekurudhore në Mitrovicë e në Ferizaj. Në prill të vitit 1942 në Gjakovë u bë atentat kundër spiunit italian Beqir Malokut, kurse në qershor të vitit 1942 në Prishtinë u vra Dr Radivoje Radivojeviqi, si udhëheqës ideor-politik i çetnikëve në Kosovë.⁴² Për këtë, okupatori dhe bashkëpunëtorët e tij ndërmorën masa të ndryshme për të zbuluar këtë veprimtari. Në fund të vitit 1941 e në fillim të vitit 1942 në Kosovë ngjanë disa tradhti dhe ato nëpërmes të kanaleve të BRKJ-së (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë). Për këtë u burgos një numër i madh i të rinjve, mirëpo komunistët e rinj torturave në llogore e burgje u qëndruan me trimëri.⁴³ Natyrisht, tradhtitë e dobësuan mjaft punën e rinisë antifashiste.

Në Këshillimin e Suhodollit u caktuan edhe një mori detyrash: edhe mëtej të zgjerohen organizatat e BRKJ-së, në radhë të parë te të rinjtë shqiptarë, të depërtohet në rrethet ku ende nuk kishte organizata të BRKJ-së (Vuçitërnë, Podujevë, Podgor, Drenicë), rinia të edukohet në frymën e marksizmit dhe leninizmit, të organizohet mbledhja e ndihmave.⁴⁴ Në këtë mënyrë pritej të tejkalohen lëshimet e bëra në vitin 1941 dhe në fillim të vitit 1942.

4. BRKJ dhe lëvizja antifashiste e rinisë nga Këshillimi në Suhodoll e deri në fund të vitit 1942

Puna e organizatave të BRKJ-së në Kosovë pas Këshillimit në Suhodoll, edhe pse ishin bërë disa burgime internime e tradhti nuk u ndërpre, kurse në aspektin organizativ mjaft u forcua.

⁴⁰ *Zbornik dokumenata NOR-a* (më tej vetëm *Zbornik*) bleni 1, lib. 19. dok. nr. 189.

⁴¹ Si shënimi 5, 251.

⁴² Si shënimi 1.

⁴³ AIHK, K-4/1, nr. 30; *Zbornik*, 1/19 dok. 27.

⁴⁴ Si shën. 6, 200.

Menjëherë pas këtij Këshillimi në Gjilan u mbajt Këshillimi në nivel rrethi, në të cilin u diskutua për kushtet e punës dhe u cak-tuan detyrat e mëtejshme, sepse aktivet e BRKJ-së nuk punonin ashtu siç ishte e paraparë. Në të njëjtin Këshillim u zgjodh Komiteti i Rrethit dhe sekretari Trajko Periqi.⁴⁵ Edhe në Gjakovë pas Këshillimit Krahinor të BRKJ-së u formua Komiteti i Vendit për Gjakovë, Rekë e Podrinje. Në Gjakovë në këtë kohë kishte 14 aktive të BRKJ-së nëpër lagje të qytetit. Në këto aktive kishte afër 60 komunistë të rinj, kurse në organizatën e BRKJ-së në Rahovec kishte më se 65 anëtarë.⁴⁶

Në shtator të vitit 1942 në Prizren u formua një udhëheqje e veçantë e rinisë dhe Këshilli i Vendit i Lidhjes së Rinisë Antifashiste dhe Popullore, që filloi punën në gjysmën e dytë të vitit 1942, përkatësisht menjëherë pas Këshillimit në Suhodoll. Në Këshillin e vendit të Lidhjes së Rinisë Antifashiste dhe Popullore në Prizren u zgjodhën të rinjtë shqiptarë, serbë, malazezë etj. Në anën tjetër, gati në të gjitha fshatrat serbe Lidhja e Rinisë Antifashiste dhe Popullore punonte aktivisht.⁴⁷

Nga tetori i vitit 1942, për kundër reaksionit e kuadrit të dobët, organizatat e BRKJ-së ishin mjaft të forta. Në këtë periudhë në Kosovë në BRKJ janë pranuar edhe 47 të rinj shqiptarë, që ndikoi pozitivisht në lëvizjen e rinisë antifashiste.⁴⁸ Në territorin e Pejës dhe të Istogut në këtë kohë kishte 542 komunistë të rinj, prej tyre 40 shqiptarë; në Prishtinë kishte 615 anëtarë të BRKJ-së e prej tyre 24 shqiptarë, në Ferizaj kishte 551 anëtarë të BRKJ-së e në Prizren 87 anëtarë.⁴⁹ Në fund të tetorit të vitit 1942 në Kosovë ishin 2160 komunistët të rinj.⁵⁰

Në nëntor të vitit 1942 në rrethin e Prishtinës formohen aktive të reja, siç janë: aktivi i hekurudhës, aktivi i romëve dhe aktivi i muslimanëve. Në fshatin Uglar u formua aktivi i parë i BRKJ-së.⁵¹ Raste të tilla kishte edhe në viset e tjera të Kosovës.

Në Mitrovicë, me 6 nëntor të vitit 1941 të rinjtë festuan përvjetorin e 25 të Revolucionit të Tetorit, në të cilën morën pjesë 20 të rinj e që ishte përgatitur më tepër se një muaj.⁵² Festimi i përvjetorit të Revolucionit të Tetorit në këtë vit u shënuar edhe në qytetet e tjera të Kosovës.⁵³

Njëri ndër manifestimet më të mëdha të vëllazërimit e të bashkimit të rinisë shqiptare, serbe dhe malazeze ishte ai që u bë me rastin e varrosjes së Aca Mërdakoviqit. Rinia e këtij qyteti në kortezhin funeral mori pjesë masivisht, ndërsa mbi varrin e të vrarit foli i riu Muhedin Shehu.⁵⁴

⁴⁵ Si shën. 35, fq. 116 dhe 141.

⁴⁶ Si shën. 9, 99.

⁴⁷ Si shën. 3, 57—58.

⁴⁸ Si shën. 6, 202—293.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Zbornik, 1/19. dok. nr. 28.

⁵¹ Si shën. 1.

⁵² Si shën. 5, 354.

⁵³ AIHK, K—18/2 nr. 227/3.

⁵⁴ Si shën. 1.

Përveç forcimit organizativ të BRKJ-së në këtë vit u shënuan rezultate edhe në formimin e Rinisë Nacionalçlirimtare dhe Popullore. Te rinia sërbe e malazeze u arritën rezultate të mira, ndërsa formimi i kësaj Lidhjeje te rinia shqiptare ende nuk kishte marrë karakter masiv.⁵⁵

Në fund të vitit 1942 pushteti okupues dhe kuisling mori masa të rrepta kundër pjesëtarëve të LNÇ-së, pra edhe kundër komunistëve të rinj. Kjo e goditi edhe KK të BRKJ-së dhe për këtë nuk mundi të funksionojë në përbërje të plotë. Një numër i mirë i organizatave të BRKJ-së u shkapërderdh dhe u shkatërrua e puna në përgjithësi u dobësua. U burgos Mita Milkoviqi, sekretar i KK të BRKJ-së, u pushkatu Jovanka Radivojeviqi, Rada Klajiqi e Branko Gërkoviqi punonin në rrethin e Nerodimes, kurse Qamil Brovina punonte në Gjakovë. KK i BRKJ-së nuk punoi në përbërje të plotë deri në tetor të vitit 1944.⁵⁶

Kjo situatë e vështirë ndikoi negativisht në formimin e bashkimit të gjeneratës së re të Kosovës. Pas burgimit të Mita Milkoviqi, KK të BRKJ-së e udhëhiqte Stanko Buriqi, mirëpo së shpejti edhe ai u vra e KK i BRKJ-së deri në prill të vitit 1943 mbeti pa udhëheqës. Që nga prilli i vitit 1943 KK të BRKJ-së e udhëhiqte Sasha Javorina.⁵⁷

Marrë në përgjithësi, puna e BRKJ-së në Kosovë ishte e suksesshme, po njëherit përcillet me një sërë të metash dhe lëshimesh.

Edhe pse në fillim të vitit 1942 edhe vetë pushteti okupues dhe kuisling pranon se komunizmi kishte ihtarë midis shqiptarëve e veçanërisht në radhët e kësaj rinie,⁵⁸ udhëheqësit e organizatave të BRKJ-së në Kosovë nuk gjetën mënyrë që të depërtojnë te kjo rini dhe të arrijnë rezultatet e dëshiruara, d.m.th. edhe në këtë vit nuk u tejkalua qëndrimi sektar dhe mosbesimi ndaj rinisë shqiptare, edhe pse nuk mund të mohohen rezultatet e arritura.⁵⁹ KK i PKJ-së për Kosovë e Metohi nuk botonte buletinin e vet dhe nuk dha udhëzimet e duhura që të ndihmonin punën e BRKJ-së në Kosovë.⁶⁰

Në vitin 1942, përkundër lëshimeve, puna e BRKJ-së në Kosovë edhe mëtej zgjerohet krahas me masivizimin e rinisë dhe të BRKJ-së. Vërtet, organizatat e BRKJ-së në Kosovë zhvilloheshin krahas me dinamikën, konsolidimin dhe zgjerimin e organizatave partiake në kuadër të të cilave punonin edhe këto.

5. Puna dhe pjesëmarrja e të rinjve komunistë dhe përparimtarë në njësitet e UNÇ dhe puna e rinisë nëpër burgje e llogore

Rinia përparimtare dhe anëtarët e BRKJ-së në Kosovë me shumicë morën pjesë në LNÇ e Revolucion, sepse ajo ishte më së shum-

⁵⁵ AIHK, K—4/1. nr. 30.

⁵⁶ Si shën. 6, 203.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Si shën. 5, 335.

⁵⁹ »Jedinstvo«, Prishtinë, 28 gusht 1961, 10.

⁶⁰ Si shën. 17, 164.

ti e orientuar kundër fashizmit, e frymëzuar me ndjenja patriotike dhe e ndikuar nga idetë e PKJ-së. Për këtë nuk duhet çuditur që KK i PKJ-së që nga fillimi e deri në fund të Luftës rininë dhe lëvizjen e rinisë antifashiste e trajton si një rezervuar të PKJ-së dhe të LNÇ-së. Kjo edhe u vërtetua. Më se gjysma e pjesëtarëve të njësiteve të rregullta të LNÇ-së ishin të përbëra nga të rinjtë.⁶¹

Çdo njësi e re partizane ishte e formuar kryesisht me të rinj. Për këtë në secilin njësit partizan u formua dhe vepronte organizata e BRKJ-së. Ajo vetes i shtronte dhe kryente detyra të ndryshme në kohë paqe e luftime. Mirëpo, edhe nëpër këto organizata bëheshin lëshime e gabime, që ndikuan në dobësimin e strukturës organizative dhe të punës së rinisë në përgjithësi. Të rinjtë dhe anëtarët e BRKJ-së nuk ndjenin më nevojë tubimi nëpër aradha e njësite të tjera partizane. Ndihehin si luftëtarë, ndërsa anën politike e organizative të BRKJ-së e lanë anash.⁶² Kjo u pa dhe për këtë rregullisht u morën masa, si nga ana e anëtarëve të BRKJ-së, ashtu edhe nga ana e anëtarëve PKJ-së. Për këtë shpesh organizoheshin kurse, në të cilat, përveç të tjerash, punohet në ngritjen ideo-politike.⁶³

Përkundër këtyre lëshimeve nga ana e të rinjve, trimëria dhe revolucionariteti në njësite ishte në nivel. Në njësitet e LNÇ u formuan njësite të veçanta luftarake nga të rinjtë, ndërsa të rinj kishte edhe në Batalionin Përcjellës të Shtabit Kryesor, përkatësisht të Shtabit Operativ të UNÇJ të Kosovë e Metohisë.⁶⁴

Rinia e Kosovës u farkua në aksione të ndryshme dhe në punën e drejtpërdrejtë të PKJ-së dhe BRKJ-së, brenda këtij viti i mënjanoi gradualisht të metat e veta dhe kështu u bë faktor qenësor, edhe si organizatë në njësitet e ndryshme luftarake.

Qysh më 1941 puna e rinisë përparimtare pengonte stabilizimin e pushtetit okupues dhe kuisling. Aktiviteti i forcuar i rinisë u përcoll me reaksionin e fortë nazist e fashist. Në këtë kohë, përveç komunistëve e simpatizantëve të LNÇ u internuan apo u burgosën një numër i madh të rinjsh.

Deri në tetor të vitit 1942 u internuan afër 500 aktivistë të LNÇ-së, të cilët ishin anëtarë të BRKJ-së e të rinj përparimtarë.⁶⁵ Në Mitrovicë që nga 19 maji të vitit 1942 e deri në gusht të të njëjtit vit u burgosën 46 aktivistë të LNÇ-së, prej të cilëve 25 komunistë dhe 18 anëtarë të BRKJ-së.

Anëtarët e BRKJ-së dhe të rinjtë përparimtarë të Kosovës u internuan apo u burgosën në llogore e burgje të ndryshme të Kosovës, Jugosllavisë, Shqipërisë (Tiranë, Pukë) dhe të Italisë (Ponca, Gajet). Në masën e të internuarve në llogorin e Pukës 40 prej tyre ishin anëtarë të PKJ-së e 70 anëtarë të BRKJ-së.⁶⁶

⁶¹ Fadilj Hodža, *Prve partizanske jedinice na Kosovu i Metohiji*, Ustanak Naroda Jugoslavije 1941, Beograd 1961, 141.

⁶² Zbornik 1/19 dok. nr. 132.

⁶³ AIHK, K—9/2 nr. 82.

⁶⁴ AIHK, K—9/3 nr. 83.

⁶⁵ Si shën. 17, 168—169.

⁶⁶ AIHK, K—6/4 nr. 56.

Edhe në llogore e burgje aktivistët e LNÇ-së ishin të ndikuar nga linja e PKJ-së. Vetëdija revolucionare e të rinjve ishte në nivelin e vijës së komunistëve. Ata formuan organizatat e tyre që veporin së bashku me organizatat e PKJ-së. Disa të rinj, në sajë të aktivitetit të tyre nëpër burgje e llogore, u pranuan edhe në PKJ.⁶⁷

Të rinjtë nëpër llogore dhe në disa burgje mbanin mbledhje, në forma të ndryshme përcillnin situatën politike e ushtarake, përgatitnin dhe merrnin pjesë në ikje, mbanin lidhje dhe forconin vëllazërimin e bashkimin. Muharrem Bekteshi, anëtar i Komitetit të Vendit të BRKJ-së në Mitrovicë në burgun e Tiranës u vra, duke rezistuar kundër okupatorit kur deshën t'i pushkatojnë sërëbët e burgosur.⁶⁸

Lidhjet e përhershme të të burgosurve dhe të internuarve dhe qëndrimi i tyre heroik kurajonte të rinjtë e tjerë për punë në njësitet apertizane si edhe në vendet e tjera.

6. Puna aksionet dhe organizimi i lëvizjes së rinisë në vitin 1943 deri në kohën e kapitullimit të Italisë fashiste

Në vitin 1943 e deri në kohën e kapitullimit të Italisë fashiste BRKJ dhe lëvizja antifashiste e rinisë punuan në kushte mjaft të vështira për shkak të terrorit, internimit dhe të burgosjeve. Mirëpo, puna e BRKJ-së dhe e lëvizjes revolucionare të rinisë nuk u ndërpre as në këtë kohë, përkundrazi edhe mëtej u zgjerua, si për nga aktiviteti, ashtu edhe për nga shtimi i numrit.

Në janar të vitit 1943 një grup i anëtarëve të BRKJ-së nga Lipjani në një aksion arriti të sigurojë një makinë shkrimi dhe një thes me material sanitar.⁶⁹

Rinia e organizuar, veçanërisht ajo shqiptare, në shkurt të vitit 1943 në Gjakovë, Prishtinë dhe në Prizren, manifestimin e organizuar nga ana e okupatorit e ktheu në demonstratë antifashiste,⁷⁰ kurse në Suhodoll bëhet riorganizimi dhe zgjerimi i BRKJ-së që kishte 17 anëtarë.⁷¹ Po në të njëjtën kohë puna e BRKJ-së në Mitrovicë ishte përmirësuar mjaft. Në këtë kohë kjo organizatë shtohet në 114 anëtarë, që u tubuan në 10 aktive të qytetit, 4 në Stari Tërg, 2 në Tunel të Parë, 3 në Vuçitërnë dhe nga një në Pestovë, Neda-kovc, Svaraçak, Vilancë si edhe 6 aktive të Ibrit dhe një në menzën e të ikurve.⁷²

Edhe në muajin mars u shënuan një sërë aksionesh të BRKJ-së dhe të rinisë përparimtare të Kosovës. Terrori dhe represaljet e okupatorit kundër popullsisë së pafajshme shqiptare i dhanë mundësi BRKJ-së (edhe PKJ-së) dhe rinisë antifashiste që në shenjë

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Si shën. 51, fq. 337.

⁶⁹ Si shën. 30, fq. 95.

⁷⁰ Si shën. 9, fq. 203.

⁷¹ Si shën. 1.

⁷² Si shën. 5, fq. 337.

proteste të organizojnë mbylljen e shkollave dhe enteve në të cilat punonin.⁷³ Edhe në Ferizaj në këtë kohë u formua një aktiv i BRKJ-së me 6 të rinj shqiptarë,⁷⁴ ndërsa në Lipjan u rrit numri i të rejave dhe filloi puna në formimin e BURAJ-it.⁷⁵

Puna dhe aktiviteti i rinisë së Kosovës në këtë kohë e pengon edhe mëtej pushtetin e okupatorit dhe të kuislingëve. Për këtë edhe në mars të vitit 1943 në Mitrovicë bëhen sërish burgime të anëtarëve të BRKJ-së. BRKJ, megjithatë, nuk ndërpreu punën. Veçanërisht, veprojnë organizatat e BRKJ-së në Tunel të Parë dhe në Stari Tërg.⁷⁶ Në të njëjtën periudhë u bënë burgosje edhe në Ferizaj, Gjilan dhe në Prishtinë.

Në prill të vitit 1943, duke punuar sipas udhëzimeve të Letrës Direktive të KK të BRKJ-së punohej në shumëzimin e materialit propagandistik në gjuhën shqipe e pastaj shpërndahej, në forcimin e vëllazërim-bashkimit, ndërsa ata të rinj komunistë që ishin komprometuar inkuadroheshin në aradha.⁷⁷

Në muajin maj të 1943 këtij viti në Prizren bëhet riorganizimi i Komitetit të Vendit. Sekretare e Komitetit të Vendit bëhet Vidra Kovaçevići.⁷⁸

Në Prizren, në fund të gushtit erdhën Vahide Kabashi, Drita Dobroshi, Drita Shehdula dhe Nasibe Zhubi. Pas ardhjes së këtyre puna me të rejat shqiptare të kësaj rrethine zgjerohet mjaft. Edhe numri i të rejave antifashiste shtohet dhe barazohet me numrin e të rejave serbe e malazeze.⁷⁹

Përveç këtyre aktiviteteve dhe përveç këtij zgjerimi në Kosovë në vitin 1943 rinia antifashiste dhe BRKJ bëri edhe aksione, mbledhje dhe aktivitete të tjera.

Brenda vitit 1943 në rrethin e Prishtinës, në Minierën »Kosova« dhe në fshatrat Stara Grackë, Dobratin, Obiliq dhe në fshatrat e tjera u pranuan në BRKJ një numër i anëtarëve dhe kështu u përtërinë dhe u riorganizuan këto organizata të BRKJ-së.⁸⁰

Punë e mirë u bë edhe me ata të rinj të cilët u detyruan të shpërngulen. U udhëzuan që të mos ndërpresin aktivitetin e tyre antifashist edhe jashtë Kosovës dhe atje të inkuadrohen në aksione të ndryshme të PKJ-së.⁸¹ Edhe rubrikat e gazetave dhe të fletushkave të kësaj kohe, ku flitej për aktivitetin e të rinjve, ndikuan mjaft në aktivitetin e rinisë.⁸²

Për vitin 1943 vlen të përmendet puna e rinisë së Kosovës me pionierë. Në anën tjetër në këtë kohë në Kosovë bëheshin përgatitjet për mbajtjen e Kongresit të BURAJ-it dhe u caktuan delegatët e mundshëm për këtë tubim.⁸³

⁷³ Si shën. 91, fq. 131; AIHK, dok. 1116.

⁷⁵ Si shën. 18, fq. 27—27.

⁷⁶ Si shën. 5, fq. 335.

⁷⁷ Si shën. 5, fq. 335; Si shën. 18, fq. 205.

⁷⁸ Si shën. 3, fq. 128.

⁷⁹ Si shën. 3, fq. 137.

⁸⁰ Si shën. 1.

⁸¹ Si shën. 17, fq. 180.

⁸² Si shën. 9, fq. 130.

⁸³ Si shën. 3, fq. 159.

Siç po shihet, që nga fillimi i vitit 1943 e deri në kapitullimin e Italisë fashiste, krahas një morie vështirësish, lëvizja revolucionare e rinisë jo vetëm që u zgjerua deri diku, por as aksionet nuk i ndali.

7. BRKJ dhe lëvizja antifashiste e rinisë së Kosovës që nga fundi i vitit 1943 e deri në çlirimin e Kosovës

Kapitullimi i Italisë fashiste ndikoi në shtimin e anëtarëve të BRKJ-së, sepse një pjesë e masës pa shkatërrimin e shpejtë të okupatorit, mirëpo BRKJ në këtë kohë punon në kushte tejet të vështira ngase armiku forcoi masat kundër pjesëtarëve të LNÇ-së dhe UNÇ-së.

Në kushte të tilla, në gjysmën e parë të tetorit të vitit 1943 KK i PKJ-së dhe KK i BRKJ-së punoi mjaft në masivizimin e punës dhe forcimin organizativ të rinisë në Metohi (Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Rahovec), duke korrigjuar kështu gabimet e bëra rreth masivizimit.⁸⁴ Gabime të tilla në këtë kohë u bënë edhe në viset e tjera të Kosovës.

Në nëntor të vitit 1943 BRKJ u bë edhe më e pavarur. U bë spastrimi i organizatave të BRKJ-së nga elementët e luhatshëm dhe të dobët. U zgjerua Lidhja e Rinisë Antifashiste e Popullore dhe u formuan një numër i madh i organizatave të BRKJ-së. Numri i anëtarëve të BRKJ-së me shqiptarë u rrit. Sipas udhëzimeve të KK të BRKJ-së u lëshuan bërthamat dhe u formuan udhëheqjet rajonale e komunale. Megjithatë edhe mëtej ka individë të PKJ-së që nënçmojnë punën dhe rolin e BRKJ-së.⁸⁵ Gjatë dhe në fund të nëntorit në Prizren e në Gjilan u bënë ndryshime në komitetet e rrethit dhe të vendit. Sekretar i Komitetit të Rrethit në Gjilan u zgjodh Bora Kataniqi, ndërsa sekretar i Komitetit të Vendit Dragutin Trajiqi. Në Prizren sekretar u zgjodh Aleksandar Martinoviqi.⁸⁶

Gjatë muajit nëntor dhe muajit dhjetor të vitit 1943 u zgjeruan organizatat e BRKJ-së në Lipjan për 20 anëtarë dhe kështu u grumbulluan 40 anëtarë të BRKJ-së, prej të cilëve 15 anëtarë ishin të gjinisë femërore. Nga fundi i vitit 1942 dhe fillimi i vitit 1943 në BRKJ kishte gjithsej 4—5 anëtarë.⁸⁷ Për shkak të shpërnguljes dhe të inkuadrimit të të rinjve komunistë në njësitet partizane, numri i anëtarëve të BRKJ-së në Ferizaj në fund të dhjetorit të vitit 1943 u zvogëlua mjaft. Puna vijon vetëm në qytet, kurse Komiteti i Rrethit gati nuk punonte. Me këtë puna me të rinjtë e fshatrave u zvogëlua shumë, mirëpo puna me rininë shqiptare megjithatë dallohet.⁸⁸

⁸⁴ Zbornik. I/19. dok. nr. 52.

⁸⁵ Po aty, dok. nr. 60.

⁸⁶ Si shën. 3, fq. 148; si shën. 35, fq. 181. Sipas disa të dhënave sekretar KV të BRKJ-së në Prizren në këtë kohë u zgjodh Kërsta Kovaqeviqi (si shën. 3, fq. 148).

⁸⁷ Si shën. 1.

⁸⁸ Si shën. 18, fq. 221—222.

Në të njëjtën kohë në Gjilan puna e BRKJ-së dhe e rinisë antifashiste u dobësua mjaft edhe pse shumica e të rinjve ishte nën ndikimin e BRKJ-së dhe të Lidhjes së Rinisë Antifashiste Popullore.⁸⁹

Qysh në fillim të vitit 1944 pushteti okupues pandërprerë ndiqte lëvizjen revolucionare të të rinjve. Kështu, në këtë kohë, d.m.th. në dhjetor e janar të këtij viti, në Prishtinë prej 33 anëtarëve shqiptarë të PKJ-së e të BRKJ-së të pakët ishin ata që nuk u burgosën apo u likuiduan.⁹⁰ Përndryshe, në fund të janarit të këtij viti në Kosovë kishte afër 2.000 anëtarë të BRKJ-së që pa u lodhur zbatonin direktivat e PKJ-së.⁹¹ Përkundër të këtij numri të anëtarëve të BRKJ-së, BRKJ nuk arriti në këtë kohë të depërtojë në radhët e rinisë shqiptare. Kjo nuk u arrit as në mars të këtij viti. Në këtë vit BRKJ nuk arriti të depërtojë as në fshatrat serbe të vendit. Përveç kësaj ende shihen mosgjeturi dhe ngathtësi si edhe mbyllje në vetvete.⁹²

Që nga muaji mars i vitit 1943, sipas Letrës Direktive të KK të BRKJ-së, filluan të eliminohen gabimet që u bënë sipas udhëzimeve të Këshillimit VI të KK të PKJ-së (nëntor 1943) mbi punën me organizatat legale dhe gjysmëlegale.⁹³

Përveç punës në formimin e Lidhjes së Rinisë Antifashiste e Popullore, në gjysmën e parë të vitit 1944 dhe në gjysmën e prillit të të njëjtit vit, rinia përparimtare e Kosovës i dërgoi letër përshëndetëse Kongresit II të BURAJ-it, të cilën e nënshkruan 1.150 të rinj shqiptarë, serbë, malazezë e të tjerë. Kongresin e përshëndeti sekretari i mëparshëm i Komitetit të Rrethit të Pejës Zhivko Stojanoviqi. Ai theksoi se edhe rinia e këtij territori do të vijojë luftën deri në çlirimin definitiv të vendit. Kongresi II i BURAJ-it në Këshillin Qendror zgjodhi edhe delegatë të Kosovës Xhafer Vokshin dhe Milan Miçkoviqin.⁹⁴

Në mars dhe në prill të vitit 1944 ndihej mungesë e kuadrove edhe në radhët e PKJ-së edhe në radhët e BRKJ-së. Për këtë arsye deri në këtë kohë nuk u formua KK i BRKJ-së. Edhe përkundër kësaj organizatat e BRKJ-së në Kosovë punonin mirë.⁹⁵ Kështu, në Prizren, edhe pse një numër i anëtarëve të BRKJ-së ishte pasivizuar, BRKJ ishte në rritje e sipër (në këtë kohë në qytet kishte 50 anëtarë të BRKJ-së). Kjo shihet veçanërisht në aktivizimin e rinisë shqiptare dhe të pionierëve.⁹⁶

Rritje në masivizim dhe sukses në aksionet e BRKJ-së u shënuan edhe në muajin maj të vitit 1944. Në Lipjan më 6. V. 1944 u mbajt një konferencë e zgjeruar në të cilën u tubuan më se 40 anëtarë të BRKJ-së.⁹⁷ Në Prizren në këtë kohë shihet një sukses i dukshëm i punës me rininë shqiptare, kurse BRKJ në Rahovec edhe

⁸⁹ Zbornik I/19 dok. nr. 78.

⁹⁰ Si shën. 17, fq. 187.

⁹¹ Po aty.

⁹² Zbornik I/19 dok. nr. 101.

⁹³ Zbornik I/19 dok. nr. 104.

⁹⁴ Si shën. 6. fq. 345, Zbornik I/19 dok. nr. 110.

⁹⁵ Zbornik I/19, dok. nr. 112 dhe 117.

⁹⁶ Si shën. 3, fq. 170.

⁹⁷ AIHK, K—18/2 nr. 227/1; K—25. dok. 433; Zbornik I/19 dok. 131.

mëtej zgjerohet.⁹⁸ Pokështu, në Gjakovë në këtë kohë punohet në masivizimin dhe në zgjerimin e BRKJ-së.⁹⁹ Për shkak të aktivitetit të të rinjve antifashistë në maj të vitit 1944 në Mitrovicë pushteti okupues dhe shërbëtorët e tyre burgosën një grup të anëtarëve të PKJ-së dhe të BRKJ-së.¹⁰⁰ Në këtë kohë burgime masive u bënë edhe në Kamenicë.¹⁰¹ Për këtë arsye, që nga muaji maj e deri në muajin gusht të vitit 1944 puna e rinisë antifashiste në këto vende vetëm që nuk u ndërpre. Sipas udhëzimeve të KK të PKJ-së gjatë gushtit të vitit 1944 BRKJ punoi në eliminimin e gabimeve të bëra dhe në forcimin e punës ilegale e konspirative. Ata anëtarë të BRKJ-së që ishin të kompromituar u udhëzuan e dërguan në aradha.¹⁰² Në vitin 1944 në Ferizaj puna e BRKJ-së dhe e rinisë antifashiste u dobësua mjaft. Mirëpo, që nga shtatori i vitit 1944 puna e BRKJ-së dhe e rinisë antifashiste në këtë vend mori hov të madh. Atëherë në qytet kishte 7 aktive të BRKJ-së me 33 anëtarë të BRKJ-së si edhe grupe të Lidhjes së Rinisë Nacionalçlirimtare dhe të pionierëve. Mungesa e aktiveve të të rinjve shqiptarë ndihej edhe në këtë kohë. Në qytet kishte gjithsej dy anëtarë shqiptarë të BRKJ-së. Edhe në fshatra dhe komuna puna e BRKJ-së kishte përparuar mjaft. Në fshatin Talinoc kishte dy aktive me 13 anëtarë të BRKJ-së dhe një grup i Lidhjes së Rinisë Antifashiste e Popullore. Në Softoviq dhe në Duganjevë ekzistonte nga një aktiv i BRKJ-së. Puna revolucionare e të rinjve hetohet edhe në Shtime.¹⁰³

Gjatë vitit 1944 BRKJ dhe lëvizja revolucionare e rrethit të Prishtinës shënojnë suksese, si në shtimin e numrit, ashtu edhe në aksione. BRKJ me sukses u spastrua nga fraksioni që u shfaq gjatë këtij viti. Nga radhët e BRKJ-së u larguan 60 anëtarë, mirëpo kjo jo vetëm që nuk e dobësoi lëvizjen, por e forcoi edhe më shumë. Megjithatë puna me rininë shqiptare as në këtë kohë nuk ishte as për së afërmi si pritej dhe kërkohet.¹⁰⁴ Përndryshe, numri i aktiveve të BRKJ-së mbeti i pandryshuar.¹⁰⁵ Në fshatrat Lipjan, Staro Grackë dhe Obiliq numri i të rinjve simpatizantë të LNÇ u rrit dukshëm.¹⁰⁶

Rritjen dhe suksesin e rinisë revolucionare të Kosovës në vitin 1944 e vërteton edhe formimi i Komitetit Krahinor të BRKJ-së dhe formimi i BURAJ-it të Kosovës dhe Metohisë.

Komitetin e ri të BRKJ-së e përbënin: Mita Milkoviqi (sekretar), Milan Miçkoviqi, Stanoje Aksiqi, Xhafer Vokshi, Sava Kovaçeviqi dhe Milka Gjilasi. Komiteti i ri u formua në tetor të vitit 1944 në fshatin Kolesjan të Shqipërisë.¹⁰⁷

⁹⁸ Zbornik, I/19 dok. 136.

⁹⁹ Si shën. 9, fq. 150.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰⁰ »Zëri i Rinisë« nr. 7. 1979.

¹⁰¹ Si shën. 35. fq. 210.

¹⁰² Zbornik I/19 dok. nr. 143—151.

¹⁰³ Zbornik I/19 dok. nr. 178.

¹⁰⁴ AIHK, K—24 dok. nr. 491 dhe 492.

¹⁰⁵ Si shën. 1.

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Si shën. 6,346.

Konferencën e formimit të BURAJ-it në Kosovë e përgatiti Këshilli Iniciator, të cilin e formoi KK i BRKJ-së. Me kërkesën Këshillit Iniciator, në muajin tetor të vitit 1944 në të gjitha rrethet u zgjodhën delegatët për këtë tubim. Konferenca I e BURAJ-it u mbajt më 17 dhe 18 tetor 1944 në Gjakovën e çliruar. Morën pjesë delegatët e të gjitha viseve të Kosovës dhe të njësiteve të UNC-së që gjendeshin në këtë territor. Konferenca zgjodhi Këshillin Krahinor të BURAJ-it për Kosovë dhe Metohi dhe solli rezolutën e proklamatën në të cilën theksohen detyrat e rinisë së Kosovës.¹⁰⁸ Pas Konferencës në të gjitha rrethet u mbajtën konferencat e rrethit të BURAJ-it, në të cilat u zgjodhën këshillat e rrethit të BURAJ-it. Kështu, në fund të vitit 1944 organizata e rinisë antifashiste ishte organizatë masive dhe organizativisht e formuar.¹⁰⁹

Për orientim të drejtë të punës me rini është e rëndësishme edhe Konferenca II e BURAJ-it për Kosovë dhe Metohi, e cila u mbajt prej 15 deri 19. IX. 1945 në Prizren. Këtu u shqyrtuan sukseset dhe të metat e punës së BRKJ-së e të BURAJ-it dhe pas referatit dhe diskutimit u soll edhe rezoluta mbi punën e mëtejshme.¹¹⁰

Deri në maj të vitit 1945 BRKJ dhe lëvizja antifashiste e rinisë arriti rezultate të rëndësishme në sendërtimin e detyrave të parashtruara.

Që të inkuadrohet sa më mirë rinia shqiptare në Frontin e Unjësuar të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, KK i PKJ-së vendosi që të formohet Rinia Antifashiste Shqiptare e Kosovës e Metohisë, si pjesë përbërse e BURAJ-it. Konferenca I e Kosovë e Metohisë, në të cilën morën pjesë të gjithë përfaqësuesit e të gjitha viseve të Kosovës u mbajt më 30. IV. 1945. Në Konferencë u zgjodh edhe Këshilli Krahinor i Rinisë Antifashiste Shqiptare, të cilin e përbënin: Xhafer Vokshi (kryetar), Nexhat Basha (nënkryetar), Ramadan Vraniqi (sekretar), Safete Nimani (arkëtare) dhe anëtarë: Mehmet Shoshi, Kadri Reufi, Sadete Bekteshi, Asllan Fazliu, Mustafa Shala, Tafil Hoxha, Murteza Luzha, Izedin Osmani dhe Rizah Azemi.¹¹¹

Rinia Antifashiste Shqiptare ndikoi mjaft në inkuadrimin e masës së rinisë shqiptare në BURAJ, veçanërisht në fshatra. Në fshatra, komune, qytete dhe rrethe u formuan këshillat e Rinisë Antifashiste Shqiptare e më vonë u formuan brigadat punuese të rinisë, kurset kundër analfabetizmit dhe grupe kulturo-artistike.¹¹²

Duhet përmendur se në prill të vitit 1945 në Kosovë kishte 3.445 anëtarë të BRKJ-së dhe kandidatë, kurse 1.236 komunistë të rinj në njësitet e armatosura, ndërsa në kohën e mbajtjes së Konferencës I të Rinisë Antifashiste Shqiptare në radhët e Armatës Popullore të Jugosllavisë gjendeshin afër 30.000 të rinj shqiptarë. Po kështu, në fund të vitit 1944 e deri në maj të vitit 1945 rinia shqiptare përbente shumicën e anëtarëve të BURAJ-it në Kosovë.¹¹³

¹⁰⁸ *Po aty.*

¹⁰⁹ *Po aty.*

¹¹⁰ *Druga Oblasna konferencija antifašističke omladine Kosovo i Metohije*, izdanje USAO Kosmeta, 1945.

¹¹¹ Si shën. 1; Si shën. 6, 348.

¹¹² *Po aty.*

¹¹³ *Po aty.*

Kështu e forcuar, mirë e organizuar dhe e spastruar nga qëndrimet dhe elementet e ndryshëm sektarë rinia revolucionare në Kosovë me sukses lufton për çlirimin definitiv të Kosovës dhe për punën e mëtejme në ndërtimin e Revolucionit Socialist.

Mr Izber Hoti

**L'ALLIANCE DE LA JEUNESSE COMMUNISTE DE YOUGOSLAVIE
ET LE MOUVEMENT REVOLUTIONNAIRE EN KOSOVOA PENDANT
LA GUERRE DE LIBERATION NATIONALE ET LA REVOLUTION
(1941—1945)**

R e s u m é

La matière de ce thème est l'étude de l'histoire de l'Alliance de la jeunesse communiste de Yougoslavie et du Mouvement révolutionnaire de la jeunesse de la Kossova pendant la Guerre de libération nationale et la Révolution, tandis que notre but principal est la présentation de la création, du développement et de l'activité de ce Mouvement en cette région.

La rédaction l'histoire de l'Alliance de la jeunesse communiste de Yougoslavie et du Mouvement révolutionnaire en Kossova exige non seulement beaucoup de temps, mais elle exige également une bonne connaissance de la matière.

Ce travail n'est qu'un essai d'une étude de toute l'histoire de l'Alliance de la jeunesse communiste de Yougoslavie et du Mouvement révolutionnaire en Kossova pendant ces années agitées de la Guerre de libération nationale et de la Révolution.

L'Alliance de la jeunesse communiste de Yougoslavie et le Mouvement révolutionnaire de la jeunesse en Kossova se développèrent dans des conditions difficiles et spécifiques. Jusqu'ici aucune étude monographique n'a été consacrée à ce sujet.

**KONTRIBUTI I PIONIERËVE
NË LËVIZJEN NACIONALÇLIRIMTARE TË KOSOVËS
(1941 — 1945)**

Partia Komuniste e Jugosllavisë, nën udhëheqjen e shokut Tito, ka qenë forca e vetme revolucionare që kombeve e kombësive të Kosovës ua ka treguar rrugën e drejtë dhe të vërtetë të lirisë, forcë kjo që ka mundur t'i tubojë dhe t'i udhëheqë në lëvizjen e luftës e përbashkët për liri, luftën për shoqërinë socialiste — bashkësinë socialiste të të gjitha kombeve e kombësive të Jugosllavisë.

Krahas pra me Luftën Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, si pjesë e saj përbërëse, u zhvillua edhe lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë.

Duke u mbështetur në platformën e përcaktuar të PKJ-së — bashkimi i masave në një front unik në luftë kundër okupatorit, për çlirimin nacional e social, për jetë më të mirë, kjo lëvizje edhe përkundër kushteve mjaft të vështira e specifike të shkaktuara nga regjimet e ndryshëm nga sunduesit e politikës së tyre »përçaj e sundo« mori përmasë të gjerë dhe u radhit në nivel me lëvizjen e mbarë Jugosllavisë duke pasur të gjitha karakteristikat e lëvizjes unike, duke e pasuruar këtë dhe duke pasur rëndësi të veçantë.

Pikërisht, linja e drejtë dhe krijuese e PKJ-së — klasës punëtore gjatë Luftës Nacionalçlirimtare qenë faktorë vendimtarë që ndikuan në zhvillimin me sukses të lëvizjes dhe të fitores së Revolucionit Socialist.

Me zgjerimin dhe forcimin e PKJ-së, zgjerohen dhe forcohen edhe organizatat partiake në Kosovë, shtohen anëtarë të rinj, formohen celula të reja, grupe skojistësh — BRKJ — grupe edukative nga radhët e të rinjve të kombeve e të kombësive që me forcën e tyre revolucionare dhe elan rinor ndikojnë në masa dhe bëjnë që të gjitha forcat përparimtare progresive të inkuadrohen në mënyrë masive në lëvizjen popullore kundër okupatorit dhe tradhtarëve të vendit. Posaçërisht angazhimi i Partisë Komuniste ka qenë më i madh rreth edukimit, orientimit dhe mobilizimit të të rinjve dhe të fëmijëve — pionierëve.

Komiteti Krahinor dhe organizatat partiake erdhën duke zhvilluar aktivitet më të gjerë për krijimin e frontit unik nacionalçlirimtar, për këtë rëndësi të veçantë që edhe direktiva e Komitetit

Qendror të PKJ e 1942 e posaçërisht organi i Partisë »Proleter« dhe artikulli i sekretarit të KQ të PKJ Josip Broz Titos i botuar në »Proleter« (dhjetor 1942).

Si rezultat i gjithë kësaj formohen njësi të armatosura partizane të cilat nga fundi i vitit 1944 bëhen tetë brigada dhe një brigadë e KNOJ-it që bashkë me njësitet në prapavijë përfshijnë afër 50.000 luftëtarë. Duke u nisur nga fakti se të rinjtë përbëjnë afërsisht 3/4 e luftëtarëve, mund të konkludojmë se sa ka qenë kontributi i rinisë, e që në të ka pasur edhe fare të rinj edhe fëmijë — pionierë që fillojnë së pari si korierë por më vonë edhe si luftëtarë të dalluar.

Në një rast kur shoku Fadil Hoxha gjendet në mesin e të rinjve duke evokuar kujtimet nga LNÇ, njëri prej tyre e pyet se çfarë qëndrimi ka pasur rinia gjatë luftës, në moment, shoku Fadil buzëqesh e, ndërmjet tjerash shton se rinia ka pasur barrën më të rëndë gjatë luftës, në të vërtetë ajo e ka bërë luftën e ndërmjet tyre ka pasur besa moshatarë edhe më të rinj se ju, por shumë revolucionarë dhe trima kanë filluar të kontribuojnë gradualisht gjatë luftës duke u rritur e kalitur në të.

Duke zbatuar në mënyrë konsekuente linjen e Partisë Komuniste dhe mendimet e shokut Tito për inkuadrimin në lëvizje dhe në LNÇ meritë e madhe u takon komunistëve nga radhët e të gjitha kombeve dhe kombësive të Kosovës të cilët kanë luajtur rolin e vet të madh revolucionar, së bashku me të gjitha kombet e kombësitë e mbarë Jugosllavisë.

Bashkimi i rinisë Komuniste të Jugosllavisë në Kosovë ka qenë masive dhe PKJ në të ka pasur mbështetje të madhe. Të rinjtë e BRKJ kanë kryer detyrat e lëvizjes me përpjekje dhe përgjegjësi të madhe, më masive ato kanë qenë në qendra të Kosovës dhe punën e tyre e kanë udhëhequr komunistët më të mirë të komiteve të vendit.

Një nga rolet më të rëndësishme gjatë LNÇ, së bashku me të gjitha forcat progresive në krye me PKJ, kanë pasur edhe voglushët e voglushet — pionierët.

Me rritjen dhe zhvillimin e lëvizjes së të rinjve në njerën anë, okupatori nga ana tjetër merr të gjitha masat e mundshme që ta zhdukë, bën burgosje, internime, varrje, vrasje, tortura, por lëvizja e të rinjve nuk thyhet. Ajo ka vazhduar rrugën e vet edhe më me revolucionaritet kundër okupatorit dhe tradhtarëve. Me entuziazmin e vet rrinor përparimtar, BRKJ në territorin e Kosovës shërben si ndihmë e madhe organizatës partiake për zbatimin e linjes të PKJ-ës në tubimin e numrit të madh të forcave përparimtare të të rinjve në kuadër të BRKJ dhe të Bashkimit të unjësuar të rinisë antifashiste të Jugosllavisë. Pikërisht mu për këtë arsye BRKJ-ës i është besuar puna dhe organizimi i fëmijëve-pionierëve, të cilën ata e kanë kryer me sukses.

Grupet e para të organizuara të pionierëve paraqiten qysh në mesin e vitit 1941 në mënyrë që në fund të këtij viti numri i pionierëve të organizuar bëhet mjaft i madh. Organizimi masiv i pionierëve ka qenë sidomos në këto qytete: Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë, Ferizaj, Prizren dhe Gjilan.

Në periudhën e zhvillimit të lëvizjes 1941—1943 pionierët i japin kontribut të dukshëm Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në mënyrë shumë aktive dhe të shkathtë ata marrin pjesë ose më mirë me thënë janë bartës të shpërndarjes së materialit propagandistik, të afisheve e të proklamatave të PKJ-së, bartin postën partiake, bëjnë lidhjet e shokëve të një baze me bazën tjetër, transferojnë ilegalët prej një baze në tjetrën, përcjellin lëvizjen e spiunëve, bëjnë dizorientimin ose japin informata të rrejshme anmikut, shkatërrojnë pjesë të mjeteve transportuese të armikut, mbledhin armë, marrin pjesë në aksione të armatosura partizane e posaçërisht kryejnë me sukses detyrën e korierëve duke lidhur paravinë me prapavinë. Gjatë veprimtarisë së tyre pionierët duke ndjekur shembullin e të rinjve komunistë kujdes të veçantë i kushtojnë kultivimit të vëllazërimit e bashkimit. Ata bashkërisht kryejnë detyra të cilat ua beson Partia edhe pse shpesh nuk e dinin gjuhën e njeri-tjetrit. Por shumë mirë e dinin dhe ishin fare të sigurtë se përpiqen për idealin e njëjtë (kështu tregon Faredini kur evokon kujtimet e veta për punën e tij si pionier dhe angazhimet që ka pasur me Momirën — Prizren).

Kryerja me sukses e shumë detyrave e sidomos të korierëve bën që angazhimi i pionierëve — fëmijëve të jetë shumë i dobishëm e i domosdoshëm. Me shtat të vogël — me zemër të madhe, pionierët lëvizin lirisht dhe në mënyrë të padiktuar kryejnë detyra të mëdha në Luftën kundër okupatorit dhe Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Se sa kanë qenë aktiv fëmijët — pionierët shihet edhe në disa dokumente e posaçërisht u janë të njohura shumë luftëtarëve të kësaj treve. Ja se si e përshkruan këtë Dragutin Gjorgjeviqi në artikullin »Diversionet në Gjakovë nën udhëheqjen e komunistëve prej vitit 1941 deri në 1944«, ... materialin e shtypur propagandistik e kanë shpërndarë nëpër shtëpi pionierët... Në prak të një majit 1942 në bazë të vendimit të Komitetit të vendit të PKJ-ës është caktuar grupi i skojistëve që ka pasur për detyrë të shpërndajë afishe rrugëve të Gjakovës... Këtyre shokëve u kanë ndihmuar pionierët që sa më shpejt ta kryejnë detyrën«. Kur flet për informuesit, Gjorgjeviqi thekson: »... pionierët kanë përcjellë lëvizjen e spiunëve e të tradhtarëve. Pionieri Ali Muhaxheri ka pasur për detyrë ta përcjellë lëvizjen e tradhtarit Hasan Bregut në të cilin është dashur të bëhet atentat. Aliu në mënyrë të pavërejtur ka përcjellë tradhtarin (puna është kryer për gjysmë ore) dhe në mënyrë të hollësishtme ka njoftuar Mazllumin e Metushin për të gjitha«.

Pionierët e Gjakovës në mënyrë masive kanë marrë pjesë në të gjitha demonstratat që janë organizuar nga Komiteti i Vëndit të PKJ-së për Kosovë e Metohi. Po cekim demonstratën e shkurtit të vitit 1943, e cila ka filluar me afër 300 demonstrantë (pionierë, skojistë, anëtarë të Partisë). Brenda sa minutash numri i demonstrantëve është shtuar prej 2.000 deri në 3.000. Në këtë demonstratë është vrarë Shani Nushi, i cili në LNÇ është inkuadruar si pionier dhe vritet si skojist.

Komiteti i Vendit e çmon këtë demonstratë si tepër të suksesshme. Vrasja e Shani Nushit, shkakton urrejtje edhe më të madhe kundër okupatorit dhe tradhtarëve të vendit. Vrasja e Shaniut e bashkon edhe më tepër rininë gjakovare pavarësisht cilit komb i takon (shqiptar, sërb, malazez, etj).

Një numër i madh i pionierëve të cilët kanë vepruar gjatë vitit 1941—1942 në vitin 1943—1944 bëhen të rinj komunistë (skojistë) dhe si të tillë inkuadrohen edhe në aradhat partizane: Nexhmedin Nixha, Tahir Spahiu, Cen Zherka, Vera Gjorgjeviq e tjerë. Në Gjakovë një numër i madh i pionierëve dallohen për aktivitetet e tyre dhe kontributin që i japin lëvizjes, si Ganimete Tërbeshi, Remzi Pula, Ferat Binishi, Hyrie Hana, Shani Nushi, Ferid Grezda, Ali Muhaxheri, Tomisllav Gjorgjeviq, Musa Dobruna, Fehmi Agani, Nazmie Brovina-Nimani, Nanie Bakalli-Deva, Myrvete Hoxha-Limani, Dobrilla Bozhoviq, Sllavko Vasiq, Sreçko Andriq, Shani Hoxha, Velko Markoviq, etj.

Pionierët në Gjakovë, sidomos të kombësisë shqiptare, janë të organizuar në një numër të madh. Nuk ka pasur lagje, nuk ka pasur rrugë në të cilën ata nuk kanë vepruar, së pari si grup e më vonë si aradha — të pionierëve.

Disa prej pionierëve më të dalluar janë edhe bartës të Përkujtimorës partizane »1941«.

Pionierët nga Peja janë të njohur sipas aksioneve të shumta. Më së shumti janë dalluar në organizimin e transferimit të ilegalëve, të lidhjeve të korierëve, informimit dhe organizimit të sabotazhës. Kështu, në mënyrë shumë të dukshme u kanë ndihmuar shokëve më të vjetër, skojistëve dhe anëtarëve të PKJ.

Është interesant rasti se si pionierët e Pejës kanë çarmatosur oficerët fashistë gjatë kohës së shfaqjes së filmit në kino. Ka edhe prej atyre që kanë qenë me pushkë në dorë. Se sa pionierët kanë mbjellë frikë me aksionet e veta të suksesshme te çetnikët e tradhtarët, mund të vërehet edhe nga letra e gjetur e një udhëheqësi çetnik nga Peja, i cili i ankohet kolegut të vet nga Mitrovica ... »kur ta merrni këtë letër, unë do të jem i vdekur dhe pikërisht nga fëmijët komunistë«. Ky është fakt se frika nga aksionet e pionierëve i ka përfshirë shumë tradhtarë të kombësisë shqiptare, sërbe dhe malazeze«.

Është e madhe lista e pionierëve të Pejës të cilët në shumë pikëpamje i kanë kontribuar LNÇ-ës në Kosovë. Do të përmendim vetëm disa prej tyre: Sveta Gjuraçiq, Misha Dragishiq, Demush Gutiq, Danica Çukiq, Nata Krushçiq, Dushanka Radulloviq, Marija Duda Boriçiq-Giliq, Zllata Strugar, Ali Hadri e të tjerë.

Në Mitrovicë në fund të vitit 1942, u masivizua organizata e pionierëve dhe SKOJ-i, pjesëmarrja dhe kontributi i pionierëve u bë gjithnjë e më i madh. Përveç detyrës që ta masivizojnë lëvizjen, ata me përkushtim punojnë për formimin e grupeve edukative të të rinjve e të pionierëve. Ata organizojnë dhe udhëheqin me këto punë të llojllojshme shoqërore, edukative-arsimore dhe ideo-politike. Me organizimin e tyre është zhvilluar edhe organizata e pionierëve. Këtu pionierët janë angazhuar si informues, korierë, kanë ndihmuar në përcjelljen e ilegalëve e të ngjashme.

Në vitin 1942 në Mitrovicë në një shtëpi, ku komunistët kremtonin ditën e Revolucionit të Tetorit ata i ruanin pionierët e Mitrovicës. Pionierët më të dalluar në Mitrovicë janë: Igballe Shukriu, Vishesllava Sekulloviq, Biserka Tomoviq, Habib Jusufi, Beqir Vocaj, etj. Ruzha Tomoviq, e cila ka filluar si pioniere dhe gjatë luftës bëhet skojiste flet me entuziazmin më të madh për shembëlltërinë e pionierës së vogël Igballe Shukriu, e cila edhe pse fëmijë ka kryer detyra shumë konspirative për Partinë. (Kështu flasin edhe luftarët e tjerë të kësaj ane). Vetë Ruzha Tomoviq është dalluar si udhëheqëse me përvojë e grupeve edukative në rrethin e Mitrovicës.

Sipas fjalëve të luftëtarëve të rrethit të Prishtinës, puna e organizatës së pionierëve dhe lëvizja në përgjithësi nuk mund të mendohet pa kontributin dhe pjesëmarrjen e pionierëve. Pionierët edhe këtu janë organizuar dhe kanë marrë pjesë në aksionet e ndryshme, sikur edhe në vendet e tjera të Kosovës, madje edhe më gjerë. Në ditët e vështira, kur armiku ka përdorur masat më drastike që ta pengojë LNÇ, pionierët kanë kryer me nderë detyra të atilla që kanë qenë shumë të rëndësishme për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes. Në përcjelljen e ilegalëve, mbajtjen e lidhjes, shpërndarjen e materialit propagandistik është dalluar si më me eksperiencë Muharrem Qena (furra e babës së tij, përndryshe anëtar shumë aktiv i PKJ, ka qenë bazë), pastaj aktiv kanë qenë: Bella Bukiq, Zorica Topalloviq, Kilibarda Radomir, Tomisllav Gjorgjeviq, Muazeze Jusufi, si dhe një numër i madh i të rinjve dhe i pionierëve nga Gjimnazi i Prishtinës.

Në gjysmën e parë të vitit 1942 në Ferizaj formohen disa grupe edukative me pionierë, të cilët edhe këtu janë organizuar në kryerjen e detyrave të rëndësishme. Sipas fjalëve të Branko Gërkoviqit, anëtar i dikurshëm i Komitetit të SKOJ-it, në Ferizaj; Partia dhe SKOJ-i i kanë kushtuar kujdes të madh punës me pionierë. Pionierët më të dalluar kanë qenë: Liljana Miliçeviq (në shtëpinë e saj ka ekzistuar baza për ilegalë), Miftar Miftari (në shtëpinë e tij ka qenë teknika partiake të cilën ai, përndryshe, në mënyrë shumë besnike e ruan si dhe materiali propagandistik, e nuk ka pasur më tepër se 10 — 12 vjet), Lubisha Vitkoviq, si kurir i shkathët, Gazmend Shaqiri, Miomira Aleksiq, Milica Pavllloviq dhe shumë të tjerë.

Në Prizren pionierët kanë qenë të organizuar shumë herët. Ndër ta dallohen: Fahredin Hadri, Spasoje Tuniq, Momirka Stanimiroviq-Tomoviq, Dragica Nekiq, Nimete Luli-Kyçyk, Gojko Gllaviq, Shaban Brikaj, Gojko Laftiq, Sadile Vraniqi, Sevdije Vraniqi, Xhavit Spahiu e tjerë. Trimëria dhe vetëmohimi i Nuredin Firzës dhe Dragica Nekiqit zënë vend të posaçëm në fletët e historisë dhe të kontributit të pionierëve Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Partia dhe SKOJ-i në Gjilan, në vitin 1942 në kryerjen e detyrave delikate ka shfrytëzuar pionierët e sprovuar e të shkathët. Duke bartur lajmet e materialin tjetër në vetë qytetin dhe në terrenin në testi të ujit dhe shporta që kinse, i bartin në varreza, si dhe me aktivitetet e tjera pionierët e Gjilanit i kanë dhënë kontributin e vet të çmueshëm LNÇ-ës. Pionierë të dalluar janë: Stanislava Çale-Dimiç, Sreçko Mihajloviq, Ollgica Gjorgjeviq, Përvosllav Kataniq, Mika Ristiç e tjerë.

Në Kamenicë janë dalluar: Sllavka Peshiq, Zhivojin Iliq e tjerë. Aktiviteti i pionierëve është vërejtur edhe në Lipjan, Vuçitërnë dhe në vendet e tjera të Kosovës.

Me zhvillimin gjithnjë e më të madh të lëvizjes edhe pionierët janë bërë gjithnjë e më aktivë, në numër gjithnjë e më të madh. Kësaj i ka kontribuar shumë kujdesi i PKJ për Kosovë e Metohi për punën me më të rinjtë. Këtë e vërteton fakti se në disa këshillime përfshirja dhe aktivizimi i të rinjve në lëvizje ka qenë tema kryesore (këshillimi i qershorit 1941).

Në korrik 1942 mbahet këshillimi partiak që parashtron detyrat konkrete mbi punën e SKOJ-it, dhe midis tjerash, thuhet: »Anëtarët e Partisë duhet të jenë më aktivë që ta tubojnë mbarë rininë nëpërmjet LNÇ, që ta edukojnë rininë në frymën e përgjithshme të luftës popullore kundër okupatorit. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtojnë përfshirjes së rinisë shqiptare, si dhe punës midis pionierëve...«. Ky është dokumenti i parë i Partisë së SKOJ-it në Kosovë që flet mbi krijimin e Lidhjes së Rinisë dhe punën midis pionierëve. Kjo do të jetë edhe bazë për organizimin e BURAJ-it dhe organizatës së pionierëve në Kosovë, që do të krijohet në gjysmën e dytë të vitit 1942.

Pas këtyre këshillimeve partiake mbahen këshillime edhe në SKOJ në rrethet e Ferizajit, Prizrenit, Prishtinës, ku parashtrohet detyra e punës me pionierë. Të gjitha këto këshillime kanë pasur rëndësi të madhe për skojistët e rinisë dhe të pionierëve në të gjitha rrethet.

Pikërisht, në këshillimin krahinor të SKOJ-it (në gusht 1942) mbajtur në Suhodoll të Lipjanit... »Përveç tjerash, konstatohet se në punën me pionierë janë arritur rezultate të mira dhe detyrat kryhen me seriozitet dhe përgjegjësi më të madhe se më parë...«

Kongresi I i BURAJ-it, mbajtur në dhjetor 1942 në Bihaç, miraton vendimin zyrtar mbi themelimin e organizatës së pionierëve. Pas këtij akti zyrtar organizata e pionierëve bëhet më e organizuar dhe më masive në tërë vendin, prandaj edhe në territorin e Kosovës. Sidomos, pas kapitullimit të Italisë në vitin 1943. Krahas me LNÇ zgjerohet edhe rrjeti i organizatës së pionierëve, kështu që ajo merr formën e vet në kuptimin organizativ gjatë vitit 1944 deri në çlirimin definitiv në tërë territorin e Kosovës.

Shumë pionierë të dalluar nga Kosova i kanë kontribuar Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe një numër i tyre në mënyrë heroike dhanë jetën në lulen e rinisë duke mos iu frikësuar as fashistëve italo-gjermanë e as tradhtarëve të vendit. Shembëlltyra e Ganimete Tërbeshit, Danica Nekiçit, Shani Nushit, Nysret Firzës do të jenë gjithmonë idol i pionierëve dhe të gjitha gjeneratave të Kosovës. Këta së bashku me një numër të madh të pionierëve të mbarë Jugosllavisë mbetën shembëlltyra të paharrueshme për të gjitha gjeneratat e kombeve dhe të kombësive të vendit tonë. Duke përkujtuar heroizmin e tyre, shoku Tito, në Kongresin I të Rinisë së Sërbisë në nëntor 1944, kështu e karakterizon heroizmin e tyre: »Kur në luftë shkojnë njerëzit, ushtria të cilën e krijoi shteti, të rriturit, atëherë kjo është detyrë ndaj atdheut të vet, atëherë ky

është borxh i secilit qytetar e atdhetar. Por, kur pa mobilizim, vullnetarisht, shkojnë në luftë fëmijët e moshës 12, 14, 15 e 16-vjeçare, të vetëdijshëm se në te do të vriten, atëherë, kjo është më shumë se borxh ndaj atdheut, atëherë ky është heroizëm i pasqoq i njerëzve tanë të cilët sakrifikojnë vetveten, megjithëse në të vërtetë ende nuk kanë filluar jetën, në mënyrë që breznitë e ardhshme të jenë të lumtura«.

Organizata e pionierëve të Kosovës ka dhënë mjaft partizanë të dalluar të cilët kanë marrë pjesë me pushkë në dorë edhe në paravijë. Një numër i tyre janë edhe bartës të Përkujtimores 1941. Shumë pionierë të dikurshëm të kalitur me kontributin që e dhanë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, vazhdojnë gjithnjë njësoj të përkuftuar në luftën për zbatimin konsekuent të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, në zhvillimin e socializmit dhe vetëqeverisjes socialiste, farkimin e vëllazërimit dhe bashkimit të të drejtave të njëmendta kombëtare, në luftë të vazhdueshme dhe pa kompromis kundër dogmatizmave dhe kundër atyre që duan të na pengojnë, gjithnjë në profesionet e tyre që sot i kryejnë, qoftë si punëtorë shoqëror-politikë, shkencëtarë, artistë, punëtorë të arsimit e tjerë.

Organizata pioniere e Kosovës si dhe organizatat e pionierëve të viseve të tjera të vendit tonë i kanë dhënë kontribut të rëndësishëm Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë dhe menjëherë pas çlirimit janë inkuadruar edhe në rindërtimin e vendit.

Në bazë të kësaj që u tha mund të përfundojmë se kontributi i fëmijëve — pionierëve gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe Revolucionit Socialist në Kosovë ka qenë i madh dhe me rëndësi të veçantë, në sajë të kujdesit të Partisë Komuniste dhe BRKJ, SKOJ-it, mirëpo kësaj radhe vetëm janë cekur ca fakte, padyshim që kjo materie meriton një studim më detal në të ardhshmen.

LA CONTRIBUTION DES PIONNIERS AU MOUVEMENT DE LIBÉRATION NATIONALE DE LA KOSOVA (1941—1945)

R é s u m é

Un rôle bien important pendant la Guerre de libération nationale, avec toutes les forces progressistes conduites par le Parti communiste de Yougoslavie, ont joué les enfants aussi, les pionniers.

Les premiers groupes des pionniers organisés apparaissent vers le milieu de l'année 1941, tandis qu'à la fin de cette année le nombre des pionniers organisés devient assez grand. Une organisation massive des pionniers a eu lieu notamment en ces villes: Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë, Ferizaj, Prizren et Gjilan.

Il s'est avéré que le rôle des pionniers était bien important et bien dans l'accomplissement de nombreuses tâches, notamment pour le courrier. Bien qu'ils étaient jeunes, les pionniers courageux se déplaçaient librement et sans être aperçus accomplissaient des tâches importantes dans le Mouvement de libération nationale.

On peut affirmer que la contribution des pionniers pendant la Guerre de libération nationale et la Révolution socialiste en Kossova a été évidente : d'une portée toute particulière.